



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____. 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

03.06.2024

Drejtuar:

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë
“BAMI HOLDING” SHPK & “CURRI” SHPK
Durrës Fushe Kruje Rruga Kamas**

Procedura e prokurimit/lotit: **“E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-99896-04-02-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Zgjerimi i superstradës Tiranë - Durrës (Faza I)”**

Fondi limit: 1,666,081,794.58 (një miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e tetë) **Lekë, pa TVSH.**

Në Euro: 16,229,123.26 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e njëzet e nëntë mijë e njëqind e njëzet e tre pikë njëzet e gjashtë) **Euro pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **24 muaj**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike: **Data 8 Prill 2024, Nr. 18**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto **X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi <input type="checkbox"/>	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe metodologjia <input type="checkbox"/>	pikët 15
Stafi / Organizimi i Kompanisë <input type="checkbox"/>	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social <input type="checkbox"/>	pikët 10
Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit <input type="checkbox"/>	pikët 10
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim <input type="checkbox"/>	

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “FUSHA” SHPK

J61922018S

Vlera: **1,615,927,936** (një miliard e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjet e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **241,35**

2. BOE “BAMI HOLDING” SHPK & “CURRI” SHPK

J94416206R / J67902718S

Vlera: **1,378,484,856** (një miliard e treqind e shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **264,15**

3. “A. N. K.” SHPK

J92408001N

Vlera: **1,566,126,408** (një miliard e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e tetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **249,45**

4. “SALILLARI” SHPK

J62903125G

Vlera: **1,605,988,989** (një miliard e gjashtëqind e pesë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **248,40**

5. BOE “ARIFAJ” SHPK & “EUROKOS HOLDING SH.P.K. DEGA NE SHQIPERI” & “XHAST” SHPK

J76418907K / K91727010A / K12512837I

Vlera: **1,404,232,428** (një miliard e katërqind e katër milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e njëzet e tetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **246,45**

6. BOE “G. P. G. COMPANY” SHPK & “VEGA” SHPK & “NG STRUCTURES” SHPK

J64324443V / K01524006L / L79326502O

Vlera: **1,486,786,868** (një miliard e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **250,95**

7. BOE “ELMAZAJ KONSTRUKSION” SHPK & “NDERTIMI” SHPK & “NDREGJONI” SHPK

L33229401T / K11325002C / K31329048I

Vlera: **1,511,321,545** (një miliard e pesëqind e njëmbëdhjetë milion e treqind e njëzet e një mijë e pesëqind e dyzet e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **235,20**

8. “GECI” SHPK

K71829801O

Vlera: **1,617,658,029** (një miliard e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëzet e nëntë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **233,40**

9. BOE “RSM Company” SHPK & “AURORA KONSTRUKSION” SHPK & “DESARET COMPANY” SHPK

810802422 / K02017003I / K01816001J

Vlera: **1,347,816,356** (një miliard e treqind e dyzet e shtatë milion e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

10. BOE “ALB TIEFBAU” SHPK & “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK & “BAJRAMI N.” SHPK

J66703049C / K81716011V / K027272020

Vlera: **1,474,294,626** (një miliard e katërqind e shtatëdhjetë e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “RSM Company” SHPK & “AURORA KONSTRUKSION” SHPK & “DESARET COMPANY” SHPK, me Numër NIPTI: 810802422 / K02017003I / K01816001J, pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kritereve të kërkuara në DST, konkretisht:

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*
- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.*

Operatorët ekonomikë janë mbështetur për punën e ngjashme në operatorë të tjerë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë të gjithë elementet e përcaktuar në **nenin 90 “Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021**, pikërisht në pikën 2 të këtij neni *“Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:*

- *t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*
- *.....*
- **Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.**

Gjithashtu, në pikën 5 të nenit 90 citohet: *“Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm”.*

-Stafi i paraqitur nga bashkimi i operatorëve nuk është në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, kjo, në kundërshtim me **nenin 88 “Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë”**, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, pika 3 *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

-OE “RSM COMPANY” nuk përmbush kriterin 2.3.4 stafin mbështetës, pasi stafi i deklaruar në shtojcën 8 është i angazhuar, kjo, në kundërshtim me pikën 2.3.7 ku thuhet: *“Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura të shpallura fituese”*

-OE “RSM COMPANY” nuk përmbush kriterin 2.3.7 “Mjetet dhe pajisjet e kerkuara”, pasi mjetet e vetëdeklaruara në shtojcën 8 janë të angazhuara, kjo, në kundërshtim me pikën 2.3.7 ku thuhet: *“Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fituese”.*

2. Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ALB TIEFBAU” SHPK & “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK & “BAJRAMI N.” SHPK, me Numër Nipti J66703049C / K81716011V / K027272020, pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht:

- Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.*

Puna e ngjashme e realizuar gjatë pesë viteve të fundit, e paraqitur nga secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk e plotëson vlerën sipas përqindjes pjesëmarrëse në kontratën e bashkëpunimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “BAMI HOLDING” SHPK & “CURRI” SHPK**, me adresë: **Durres Fushe Kruje Rruga Kameronas**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1,378,484,856** (një miliard e treqind e shtatëdhjetë e tetë milion e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra sipas sistemit **[264,15]**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në *nenin 110 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”*.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gentian Gjyli